



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1048, datë 17.11.2009

Për

**Shfuqizimin e Vendimit Nr. 644 date 26.12.2008, Autorizimi Individual për sipërmarrësin
Bankën së Parë të Investimeve.**

Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbledhjen e datës 17.11.2009, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme në fuqi, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 170, date 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 452, date 02.05.2008, e amenduar me VKD Nr. 746 dt. 17.07.09, bazuar në ligjin Nr. 9918, date 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, neni 115 “*Marrja e Vendimeve dhe Struktura e Këshillit Drejtues*”, mori në shqyrtim:

- Propozimin e Drejtorisë së Licensimit për miratimin e kërkesës së Bankës së Parë të Investimeve dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 644 date 26.12.2009.

BAZA LIGJORE :

- Ligji Nr. 9918, date 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, neni 8 – germa j) dhe neni 76 pika 1;
- Rregullorja për Autorizimin Individual miratuar me VKD Nr. 510 date 04.11.2008. neni 1, pika 1.
- Rregullorja e brendshme e AKEP miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 170 date 24.04.2004, e ndryshuar - neni 21, pika 17.
- Neni 121 e në vijim të ligjit nr. 8485, date 12. 05. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*);

Ne përfundim të interpretimit të bazës ligjore dhe kërkesës së sipërmarrësit të sipërcituar, Këshilli Drejtues

VËREHET SE :

1. Me Vendimin Nr. 644 (Prot. Nr. 919 date 16.02.2009) datë 26.12.2008, Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur të transpozojë Licencën Nr. 614/0805 date 19.08.2005 të Bankës së Parë të Investimeve dhe ta pajisë atë me Autorizim Individual për përdorimin e

frekuencave për 1 stacion VSAT. Ky Autorizim ishte përcaktuar ne vendim te ishte i vlefshëm deri me 31.12.2010.

2. Nr. 2013 Prot. date 06.05.2009 ka deklaruar qe nuk ka ne përdorim frekuenca VSAT qe nga data 01.04.2007 dhe kërkon te çlirohet nga çdo detyrim lidhur me shfrytëzimin e frekuencave.
3. Sipas pikës 3 te VKD Nr. 644 : *“Banka e Pare e Investimeve” brenda një periudhe 2 mujore nga data e këtij vendimi, duhet te paraqesë ne AKEP te dhënat e përditësuara lidhur me frekuencat qe ka ne përdorim, sipas anekseve te rregullores “Për dhënie e Autorizimit Individual” miratuar me VKD nr. 510 date 04.11.2008. Ne rast te mosplotësimit brenda afatit te kësaj pike nga “Banka e Pare e Investimeve”, Autorizimi Individual për këtë subjekt behet i pavlefshëm. Referuar pikës 3 te VKD Nr. 644 vërehet se njoftimi i Bankës se Pare te Investimeve është bere me vonese dhe Aneksit 1 i VKD Nr. 644 (Prot. Nr. 919 date 16.02.2009) date 26.12.2008 është i shfuqizuar qe nga data 16.04.2009.*
4. Neni 76 i ligjit nr. 9918 parashikon revokimin e autorizimit individual nga AKEP me kërkesën e palës se cilës i është lëshuar autorizimi.
5. Pika 1 e nenit 8 te Rregullores parashikon revokimin e autorizimit individual me kërkesën e te autorizuarit.
6. Neni 121 e ne vijim i ligjit nr. 8485 parashikon shfuqizimin/revokimin e akteve administrative individuale nga ana e organit administrativ kompetent.

V E N D O S I :

1. Të miratoje propozimin e Drejtorisë së Licensimit për miratimin e kërkesës së Bankës se Pare te Investimeve për shfuqizimin e Vendimit Nr. 644 date 26.12.2008.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit për njoftimin e Bankës së Parë të Investimeve dhe Drejtoritë e tjera për ndjekjen e efekteve qe rrjedhin nga ky vendim.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**